# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5688
E martë, 29 janar 2019
çmimi 0.40 €

## SBAShK-u kërkon plotësimin e kërkesës ose tërheqjen e Projektligjit për pagat

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RASIM SELMANAJ FAQE 4-6

# Projektligji për paga zvogëlon pabarazinë



Anëtari i Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Rasim Selmanaj, ka bërë me dije se Projektligji për paga është një hap i madh drejt nivelimit të pagave dhe uljes së pabarazisë në sektorin publik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky është maksimumi që mund të bëjë Qeveria për të punësuarit në sektorin publik.

Deputeti i AAK-së ka treguar se Projektligji për paga parash që në asnjë ndërmarrje publike të mos ketë pagë më të madhe se 1 700 euro. Selmanaj ka thënë se prej koeficientit 5 deri te koeficienti 1 pothuajse të gjithëve u është rritur paga, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, i cili ka rritje të pagës prej 0.2 përqindësh

## Veseli propozon që taksa të pezullohet për 120 ditë



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë një takimi që ka zhvilluar të hënën me ambasadorin e ShBA-së në Prishtinë, Philip Kosnett, ka bërë me dije se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës nuk duhet të hiqet, por duhet të pezullohet për 120 ditë dhe gjatë kësaj periudhe duhet të vihen në fuqi disa kushte konkrete për pezullimin e saj. "Nëse pas 120 ditësh nuk kemi një situatë të re, ku sjelljet e Serbisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës nuk ndryshojnë rrënjësisht, atëherë e njëjta taksë vazhdon", ka thënë Veseli, duke shtuar se kjo duhet të ndodhë si masë mirëbesimi ndaj ShBA-së dhe BE-së FAQE 3



## Mustafa kërkon zgjidhje nga Qeveria për përfundimin e grevave

FAQE 2

### AKTUALE



**MARRËVESHJA E PRESPËS, RAMIZI DHE UJI 'ROSA' DHE PEZULLIMI I TAKSËS!** F. 11

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**SHTYHET SEANCA PËR RASTIN 'VETERANËT'** F. 6

**KOSOVA E MAQEDONIA ARRIJNË MARRËVESHJE PËR NJOHJEN E PATENTËSHOFERËVE** F. 7

### EKONOMI

**LANSOHET FONDI PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË, KOSOVA E PARA NË RAJON** F. 8

**INVESTITORI I PARË STRATEGJIK DO TË INVESTOJË 169 MILIONË EURO PËR ENERGJINË ME ERË** F. 8



### KULTURË

**MBRESA NGA LEXIMI I NJË LIBRI** F. 13

Mr. Shefki STUBLLA

### SPORT

**TAHIRI: U LARGOVA SE NUK ISHA I RESPEKTUAR TE VUSHTRRIA** F. 18

**BURSA PËR SHPRESAT OLIMPIKE** F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Veseli propozon që taksa të pezullohet për 120 ditë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë një takimi që ka zhvilluar të hënën me ambasadorin e ShBA-së në Prishtinë, Philip Kosnett, ka bërë me dije se taksa 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës nuk duhet të hiqet, por duhet të pezullohet për 120 ditë dhe gjatë kësaj periudhe duhet të vihen në fuqi disa kushte konkrete për pezullimin e saj. "Nëse pas 120 ditësh nuk kemi një situatë të re, ku sjelljet e Serbisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës nuk ndryshojnë rrënjësisht, atëherë e njëjta taksë vazhdon", ka thënë Veseli, duke shtuar se kjo duhet të ndodhë si masë mirëbesimi ndaj ShBA-së dhe BE-së

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

Prishtinë, 28 janar - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar të hënën ambasadorin e ShBA-së në Prishtinë, Philip Kosnett. Veseli në këtë takim e ka vlerësuar dhe e falënderuar edhe një herë publikisht qëndrimin amerikan për përkrahje të sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit të Kosovës dhe perspektivës euroatlantike të vendit tonë. "Pa dyshim, ShBA-ja mbetet partnerja jonë më strategjike dhe mikja më e madhe e Kosovës në të gjitha fazat dhe proceset e lirisë dhe shtetndërtimit. Dua ta bëj të qartë se përkushtimet e ShBA-së për zgjerimin e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, për orientimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE dhe për paqen e qëndrueshme në rajon, përmes dialogut dhe fqinjësisë së mirë, janë edhe interesa vitale të shtetit tonë. Kosovës nuk i duhet kursi i konfrontimit me ShBA-të e as me BE-në. Përkundrazi! Gjuha e kushtëzimeve ndaj partnerëve tanë kryesorë strategjikë si ShBA dhe BE-ja nuk do ta ndihmojë Kosovën as në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial, e as në rrugën e saj drejt integrimeve euroatlantike", ka thënë Veseli pas takimit me ambasadorin amerikan. Ai ka thënë se Republika e Kosovës që disa muaj ka vendosur taksën doganore prej 100 përqindësh për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Sipas Veselit, taksa është vendosur si kundërpërgjigje ndaj agresivitetit politik dhe diplomatik të këtyre dy shteteve kundër shtetit, qytetarëve dhe mallrave të Kosovës. "Ky është një vendim legjitim, i drejtë, i duhur dhe i imponuar ndaj institucioneve tona që po përballen me këtë agresion, prandaj edhe do të qëndrojë në fuqi për aq kohë sa këto shtete do të kenë një politikë të tillë kundër shtetit tonë. Taksa asnjëherë nuk ka pasur dhe as nuk do të ketë orientim kundër aleatëve tanë kryesorë, ShBA-së dhe BE-së, e as kundër interesave të tyre strategjike në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Ritheksoj se interesat amerikane në Kosovë janë edhe interesa të Kosovës dhe, po ashtu, interesat e Kosovës janë edhe interesa të ShBA-së. Ky është një fakt i pamohueshëm dhe kështu do të mbetet gjithmonë", ka thënë Veseli.

Kryeparlamentari Veseli ka treguar se takimin që ka ftuar më 23 janar, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri Ramush Haradinaj dhe ambasadori amerikan Philip Kosnett, ka qenë i frytshëm dhe në funksion të gjetjes së një zgjidhjeje kalimtare në lidhje me taksën ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. "Qëllimi i takimit ka qenë afrimi dhe jo largimi me ShBA-së", ka thënë Veseli. "Andaj, shqetësimet serioze, të shprehura në deklaratën e fundit të Ambasadës amerikane, si vazhdimësi e letrës së presidentit Trump, por edhe qëndrimin konsistent amerikan në lidhje me zhvillimet e fundit në vendin tonë, i marrim me seriozitetin më të madh dhe do t'u përgjigjemi në mënyrë konstruktive. Në takimin e javës së kaluar kam dhënë një propozim konkret, të cilit i qëndroj deri në fund. Taksa doganore nuk duhet të hiqet, por ajo duhet të pezullohet për 120 ditë dhe gjatë kësaj periudhe duhet të vihen në fuqi disa kushte konkrete për pezullimin e saj. Dhe nëse pas 120 ditësh nuk kemi një situatë të re, pra nëse sjelljet e Serbisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës nuk ndryshojnë rrënjësisht, atëherë e njëjta taksë vazhdon, por edhe vendimet e tjera që me automatizëm dërgojnë në reciprocitet të plotë në këto dy vende. Besoj se ky është vendim i arsyeshëm, që e ruan dinjitetin e vendit, afirmon legjitimitetin e vendimit për taksën 100 për qind, por edhe balancon interesin shumë strategjik të Kosovës, duke ruajtur dhe shtuar raportet me partnerët tanë kryesorë, ShBA-në dhe BE-në", ka thënë Veseli, duke shtuar se qëndrimi i tij është që taksa duhet të mbetet si vendim i drejtë i Republikës së Kosovës, por të bëhet pezullimi i përkohshëm, me kohëzgjatje prej vetëm 120 ditësh, në shenjë respekti dhe mirëbesimi ndaj ShBA-së dhe BE-së.



## Rama: Pa ShBA-në, Kosova nuk do të çlirohej nga kthetrat e Beogradit

Berlin, 28 janar - Shqipëria do ta mbështesë çdo marrëveshje midis Beogradit dhe Prishtinës e cila përkrahet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE). Kështu ka deklaruar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

I pyetur mbi presionin e ShBA-së ndaj Qeverisë Haradinaj që ta anulojë taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe boshnjake, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se Amerika është e përkushtuar për Kosovën dhe se pa Shtetet e Bashkuara, Kosova nuk do të ishte çliruar nga kthetrat e Beogradit. "Pa ShBA-në, Kosova nuk do të mund të çlirohej nga kthetrat e Beogradit dhe nuk do të mund të ishte shtet i pavarur siç është sot", është shprehur Rama për "DW"-në.

Rama, i cili ka qëndruar për vizitë zyrtare në Berlin, është pyetur edhe rreth kundërshtimit të Gjermanisë për ndryshimin e kufijve si një zgjidhje mes Beogradit dhe Prishtinës. Duke mos përmendur kufijtë, ai ka thënë se është e rëndësishme që të realizohet një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ky dialog duhet të finalizohet nga një marrëveshje historike midis Serbisë dhe Kosovës. Ne do ta përkrahim çdo marrëveshje e cila e ka mbështetjen e qartë të ShBA-së dhe BE-së", ka thënë Rama.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, u ka dërguar letër ambasadorëve të Quintit dhe përfaqësueses së Bashkimit Evropian në Kosovë

# Haradinaj kërkon plotësimin e pesë kushteve për heqjen e taksës

**Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian (BE) plotësimin e pesë kushteve për heqjen e taksës ndaj Serbisë. Ai ka kërkuar zotime publike nga ShBA-ja dhe BE-ja që në konferencën për arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të ketë rivendosjeje të kufijve ekzistues të Kosovës, ndarje ose shkëmbime territoriale, si dhe nuk do të ketë dhënie të kompetencave ekzekutive për asociacionin e komunave serbe. Një prej kushteve është edhe zotimi i BE-së që liberalizimi i vizave të hyjë në fuqi para fillimit të konferencës**




Shqipe HETEMI

Prishtinë, 28 janar - Për pezullimin e taksës ndaj Serbisë, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, të hënën ka kërkuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian inicimin dhe mbështetjen e një konference ndërkombëtare, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Nëpërmjet një letre dërguar ambasadorëve të Quintit dhe përfaqësueses së BE-së në Kosovë, Haradinaj ka kërkuar që ShBA-ja dhe BE-ja të japin zotime publike dhe të garantojnë që në konferencë, mes të tjerash, nuk do të ketë rivendosjeje të kufijve ekzistues të Kosovës, ose ndarje të Kosovës, ose shkëmbime territoriale të çfarëdo natyre, si dhe nuk do të ketë dhënie të kompetencave ekzekutive për asociacionin e komunave serbe në Kosovë apo ndonjë marrëveshje tjetër që është në kundërshtim me Kushtetutën. "Qeveria e Kosovës do ta pezullojë menjëherë tarifën në rast se plotësohen rrethanat e mëposhtme: Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE), pas marrjes së hapave praktikë për inicimin dhe mbështetjen e një konference ndërkombëtare ("Konferenca"), me qëllim të arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të pazgjidhura ndërmjet dy vendeve. Konferenca duhet të fillojë sa më parë që është e mundur pas plotësimit të rrethanave të përshkruara si dhe duhet të përfundojë brenda 14 ditëve; ShBA-ja dhe BE-ja do të japin zotime publike dhe do të garantojnë që në konferencë nuk do të ketë: çfarëdo rivendosje të kufijve ekzistues të Kosovës, ose ndarje të Kosovës, ose shkëmbime territoriale të çfarëdo natyre; dhënie të kompetencave ekzekutive të çfarëdo forme për asociacionin e komunave serbe në Kosovë ose ndonjë marrëveshje tjetër që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës; masa të çfarëdo natyre të bazuar në koncesione që shkojnë para datës 17 shkurt 2008", është thënë në letrën e Haradinajt.

Një prej pesë kushteve të kryeministrit Haradinaj për pezullimin e taksës është edhe zotimi i BE-së që liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës të hyjë në fuqi para fillimit të konferencës. "BE-ja do të japë zotime shtesë publike dhe do të garantojë se do të hyjë në fuqi liberalizimi i vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës para fillimit të konferencës; do të zbatohet dhe do të jetë plotësisht funksionale Marrëveshja për Energji e arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë para fillimit të Konferencës; është verifikuar se Serbia ka larguar të gjitha barrierat jotarifore të shkaktuara ndaj lëvizjes së mallrave nga Kosova, si dhe të gjitha kufizimeve të paligjshme në tregtinë e shërbimeve dhe lëvizjen e njerëzve nga Kosova në Serbi. Presidenti, kryeministri ose ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë konfirmojnë publikisht se janë ndaluar në mënyrë permanente të gjitha politikat dhe veprimet e çfarëdo lloji të drejtuara kundër aspiratave të Kosovës si shtet sovran qoftë nëse ato aplikohen në nivel lokal, rajonal apo ndërkombëtar", është theksuar më tutje në letrën e Haradinajt drejtuar ambasadorëve të Quintit.

Kryeministri ka bërë me dije se vetëm pas plotësimit të këtyre kërkesave, Qeveria e Kosovës do ta pezullojë taksën doganore 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, e cila është në fuqi që nga nëntori i vitit të kaluar. "Tarifa do të rivendoset menjëherë nëse konferenca nuk përfundon me një marrëveshje gjithëpërfshirëse të detyrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila siguron, ndër të tjera, njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Tarifa do të rivendoset në një datë të mëvonshme nëse nuk arrihet të zbatohet marrëveshja gjithëpërfshirëse e detyrueshme e arritur në konferencë", ka theksuar ai.

Sidoqoftë, Haradinaj ka shprehur optimizëm që këtë vit mund të arrihet marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila, sipas tij, do t'i adresojë të gjitha çështjet e pazgjidhura, duke përfshirë reparacionet e luftës, të drejtat e minoriteteve në të dyja vendet, si dhe çështjet e ndryshme ekonomike, sociale dhe kulturore, duke shpënë në njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB.

# Ministrja Hoxha takon ministren Kneissl, Austria përkrah agjendën integruese të Kosovës




Vjenë, 28 janar (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, gjatë qëndrimit në Austri, ka takuar ministren austriake të Punëve të Jashtme, Karin Kneissl, me të cilën ka diskutuar për procesin integrues të Kosovës, në veçanti liberalizimin e vizave. "E njoha nga afër me procesin integrues, të arriturat dhe sfidat, reformat e ndërmarra dhe zbatimin e MSA-së. Të arriturat tona nuk do të ishin në këtë nivel pa përkrahjen e shteteve mike, edhe Austrisë, e cila në çdo etapë të zhvillimit të shtetit tonë, ishte krah nesh. Ashtu do të ndodhë edhe në të ardhmen", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se integrimi i vendit tonë në organizatat ndërkombëtare është me prioritet.

Në veçanti ministrja Hoxha ka kërkuar nga ministrja e Jashtme e Austrisë të ndihmojë në përshpejtimin e vendimmarrjes për liberalizimin e vizave, duke pasur parasysh rëndësinë e qëndrimit të shteteve anëtare për këtë proces.

Ministrja e Punëve të Jashtme, Karin Kneissl, ka potencuar rëndësinë e reformave dhe zbatimi i MSA-së. Gjithsesi ka thënë se Austria e përkrah fuqishëm Kosovën në të gjitha angazhimet e saj, në veçanti procesin integrues dhe liberalizimin e vizave.

Flet për "Epokën e re", Rasim Selmanaj

# Projektligji për paga



**Anëtari i Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Rasim Selmanaj, ka bërë me dije se Projektligji për paga është një hap i madh drejt nivelizimit të pagave dhe uljes së pabarazisë në sektorin publik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky është maksimumi që mund të bëjë Qeveria për të punësuarit në sektorin publik. Deputeti i AAK-së ka treguar se Projektligji për paga parash që në asnjë ndërmarrje publike të mos ketë pagë më të madhe se 1 700 euro. Selmanaj ka thënë se prej koeficientit 5 deri te koeficienti 1 pothuajse të gjithëve u është rritur paga, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, i cili ka rritje të pagës prej 0.2 përqindësh**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 JANAR - Anëtari i Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Rasim Selmanaj, ka thënë se është bërë punë e mirë me Projektligjin për paga, i cili pritet të miratohet sot (e martë) në mbledhjen e këtij komisioni. Ai ka thënë se me këtë dokument është bërë një hap i madh drejt nivelizimit të pagave dhe uljes së pabarazisë ndemjet pagave në sektorin publikë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", deputeti i AAK-së ka deklaruar se është bërë zvogëlimi i pagave për të gjithë zyrtarët e lartë shtetërorë. "Me të gjitha të metat që i ka ky Projektligj, është një hap i madh drejt nivelizimit të pagave dhe uljes së pabarazisë ndërmjet pagave në sektorin publik. Nuk është pak kur kryeparlamentarit, kryeministrit, presidentit dhe deputetëve iu ulen koeficientet. Pra, ka lëvizje pozitive në këtë drejtim", ka thënë Selmanaj. Ai ka treguar se ky është maksimumi që mund të bëjë Qeveria në këtë fazë. "Për këtë fazë mendoj se ky është maksimumi që kemi mundur të arrijmë. Ajo që mbetet është se dikur, pas dy ose tre vjetësh, duhet t'i kthehemi edhe një herë këtij Projektligji në mënyrë që të gjithë me qenë më të barabartë dhe të kënaqur me mundësitë që ka Kosova", është shprehur Selmanaj.

Deputeti i AAK-së ka thënë se prej koeficientit 5 deri te koeficienti 1 pothuajse të gjithëve u është rritur paga. "Paga u është zvogëluar të gjithëve atyre që bartin përgjegjësi të larta në shtet, duke u nisur nga presidenti që e ka koeficientin 10 e deri te këta që e kanë koeficientin 5. Kurse prej pagës më të vogël e deri te koeficienti 5 mund të themi se shumicës prej tyre u është ngritur paga, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, i cili ka një rritje prej 0.2 përqindësh sikurse që ka rritje edhe për shërbyesit civilë", ka thënë Selmanaj.

**"Epoka e re":** *Z. Selmanaj, Komisioni Parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që disa ditë është duke e shqyrtuar Projektligjin për paga. A keni arritur që të gjitha partitë t'i harmonizojnë qëndrimet përfundimtare?*

Selmanaj: Si komision kemi punuar jo më pak se dhjetë ditë në një punëtori. Kemi ardhur deri te drafti final, ku të martën pritet të mbahet mbledhja e komisionit dhe të votohet Projektligji për paga, me disa ndryshime të vogla. Mendoj se për aq sa ka qenë mundësia buxhetore kemi arritur ta bëjmë një lloj nivelimi të pagave.

**"Epoka e re":** *Kujt i është zvogëluar dhe kujt i është rritur koeficienti me këtë Projektligj?*

**Selmanaj:** Ne e kemi zvogëluar tavanin i cili ka qenë koeficienti 12. Tani koeficienti më i madh është 10. Presidenti i shtetit ka pasur koeficientin 12, ia kemi zbritur në 10. Njëjtë kemi vepruar edhe me kryeparlamentarin dhe kryeministrin, të cilët tani e kanë koeficientin 9. Pastaj kemi shkuar duke ulur koeficientet e individëve të cilët kanë përgjegjësi më të larta në shtet. Për shembull, deputetët e kanë pasur 8.5 koeficientin, e kemi 8 e kështu me radhë.

# zvogëlon pabarazinë



Ndërsa kemi ngritje të koeficienteve në shëndetësi, arsim, polici, prokurori dhe gjykata. Ndoshta jo në masën që e meritojnë por, megjithatë, ka ndryshime dhe lëvizje pozitive në këta sektorë.

**"Epoka e re":** *Pra, vetëm liderëve kryesorë u është ulur paga?*
**Selmanaj:** Paga u është zvogëluar të gjithëve atyre që bartin përgjegjësi të larta në shtet, duke u nisur nga presidenti që e ka koeficientin 10 e deri te këta që e kanë koeficientin 5. Kurse prej pagës me të vogël e deri te koeficienti 5 mund të themi se shumicës prej tyre u është ngritur paga, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, i cili ka një rritje prej 0.2 përqindësh sikurse që ka rritje edhe për shërbyesit civilë.

**"Epoka e re":** *Vazhdimisht është diskutuar rreth dallimit të madh apo pabarazisë së madhe të pagave në sektorin publik. Me këtë Projektligj, sa keni arritur ta zvogëloni këtë pabarazi?*
**Selmanaj:** Me krejt defektet që i ka ky Projektligj, mendoj se me këtë draft është zvogëluar pabarazia. Ndoshta jo në masën që është dashur, për shkak se është e pamundur që në këtë fazë të bëjmë më shumë, sepse është dashur të ketë buxhet më shumë. Pra, për këtë fazë, mendoj se ky është maksimumi që kemi mundur të arrijmë. Ajo që mbetet është se dikur, pas dy ose tre vjetësh, duhet t'i kthehemi edhe një herë këtij Projektligji në mënyrë që të gjithë me qenë më të barabartë dhe të kënaqur me mundësitë që ka Kosova. Dua të rikujtoj se dy qeveritë, para Qeverisë Haradinaj, e kanë iniciuar dhe miratuar këtë Projektligj, por nuk e kanë sjellë në Kuvend, sepse po e shihni se ka krijuar shumë kërkesa dhe pakënaqësi. Megjithatë, me të gjitha të metat që i ka ky Projektligj, është një hap i madh drejt nivelimit të pagave dhe uljes së pabarazisë ndërmjet pagave në sektorin publik. Nuk është pak kur kryeparlamentarit, kryeministrit, presidentit dhe deputetëve iu ulen koeficientet. Pra, ka lëvizje pozitive në këtë drejtim.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej kësaj ulje të pabarazisë, po kundërshtohet ky Projektligj nga punëtorët e disa sektorëve. Cili është mendimi juaj për këtë?*
**Selmanaj:** Arsimi ka të drejtë në kërkesat e veta sepse e meriton një gjë të tillë, por mundësia buxhetore është tjetër. Në këtë fazë Qeveria ka pasur mundësi të bëjë këtë lëvizje prej 0.2, që gjithë sektorit të arsimit t'ia rrisë pagat. Dikujt i rriten 45 euro e dikujt 80 euro në muaj. Nuk është e mjaftueshme, por në këtë fazë kjo është mundësia.

**"Epoka e re":** *Sindikata e Arsimit është e vendosur të mos heqë dorë nga greva. Çfarë do t'i rekomandonit?*
**Selmanaj:** Mendoj se, pavarësisht prej kërkesave të ligjshme dhe të drejta të arsimit, nuk e ka përdorur metodën më të mirë për t'i kërkuar të drejtat e veta. Ka pasur edhe mundësi të tjera sindikale, jo për ta ndërprerë mësimin. Megjithatë, është e drejtë e sindikalistëve për ta përdorur këtë metodë. Mendoj se mësimdhënësit duhet t'i kthehen mësimit dhe Qeveria e Kuvendi ta bëjnë mundësinë për të lëvizur përpara në drejtim të kërkesave të tyre.

**"Epoka e re":** *Po për nivelin lokal, çfarë parasheh ky Projektligj?*
**Selmanaj:** Në këtë Projektligj janë përkrahur shumë edhe komunat. Ka ngritje të pagës së kryetarëve të komunave. Tani kryetarët e komunave e kanë koeficientin 8, pra janë barazuar me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, asamblistët komunalë kanë ngritje të koeficienteve dhe të pagës. Nga 200 euro sa i kanë marrë deri tani, paga e tyre shkon rreth 530 euro.

**"Epoka e re":** *Ka reaguar edhe Sindikata e Punëtorëve të RTK-së, e cila ka thënë se ky Projektligj punëtorët e televizionit publik i shndërron në punëtorë shtetërorë.*
**Selmanaj:** Në mbledhjen e së martës do të votoj kundër që RTK-ja të bëhet pjesë e këtij Projektligji, ku përcaktohet mënyra se sa do të jetë pagesa e tyre. Mirëpo, të gjithë duhet ta dinë se përmes këtij Projektligji nuk ndërrohet statusi i RTK-së siç po pretendojnë disa se, kinse, RTK-ja po bëhet ndërmarrje publike. Kjo nuk është e vërtetë. Me këtë Projektligj është propozuar të caktohet paga minimale dhe paga maksimale. Kurse në mes këtij tavani dhe themeli, normalisht se pagat duhet të rregullohen me rregullore të brendshme, në këtë rast të RTK-së. Pra, Projektligji për pagat nuk mund t'ia ndërrojë statusin RTK-së. Unë jam kundër që me këtë Projektligj të caktohet limiti i pagës në RTK.

**"Epoka e re":** *Sa i prek pagat e punonjësve të ndërmarrjeve publike ky Projektligj?*
**Selmanaj:** Në ndërmarrje publike, nëse nuk gaboj, nuk duhet të ketë pagë mbi 1 700 euro. Pra, sipas këtij Projektligji, nuk duhet të ketë pagë më të madhe se 1 700 euro as në PTK e as në RTK. Por, siç thashë që në fillim, ky ende është vetëm një draft i cili mund të ndryshohet në mbledhjen e së martës.

## SBAShK-u kërkon plotësimin e kërkesës ose tërheqjen e Projektligjit për pagat

GJILAN, 28 JANAR (ER) - Delegacioni i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBAShK), i udhëhequr nga kryetari Rrahman Jasharaj, në ditën e njëmbëdhjetë të grevës në arsim, ka vizituar mësimdhënësit në institucionet arsimore në Komunën e Gjilanit. Delegacioni i SBAShK-ut ka shprehur brengosjen se edhe në ditën e njëmbëdhjetë të grevës institucionet e Kosovës nuk po krijojnë gatishmëri për t'i plotësuar kërkesat e punëtorëve të arsimit. Kryetari Jasharaj ka thënë se ishte kërkesë e të gjithë grevistëve që në asnjë formë mos të ndërpritet greva pa i plotësuar kërkesat tashmë të njohura ose të tërhiqet

Projektligji për pagat. Sipas informatave të marra nga Këshillat Grevistë Komunalë, rezulton se i tërë sistemi arsimor nga çerdhet deri tek universitetet ishin në grevë. Këshilli Qendror Grevist dhe as udhëheqja e SBAShK-ut edhe gjatë ditës së hënë nuk kanë pasur asnjë takim me asnjë institucion e as udhëheqës të institucioneve në nivel lokal e as në nivel qendror. "Edhe një herë u bëjmë apel institucioneve qendrore, në veçanti ministrit Bytyqi, që të japë kontributin e tij në Qeverinë e Kosovës për realizimin e kërkesave ose largimin e Projektligjit të pagave, përndryshe grevës nuk i shihet fundi", ka thënë Jasharaj.



# Kusari dhe Deda takojnë Kosnettin, flasin për tejkalimin e sfidave që ka Kosova

**Prishtinë, 28 janar (ER)** - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, dhe deputeti i kësaj partie, Ilir Deda, kanë pritur në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett. Në këtë takim, Kusari-Lila ka bërë me dije se kanë biseduar për situatën politike në Kosovës dhe për domosdoshmërinë që partitë politike t'i marrin përgjegjësit për tejkalimin e sfidave që e presin vendin. "Kënaqësi e veçantë ta mirëpresim sot në zyrat e Alternativës ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, z. Philip S. Kosnett. Me ambasadorin Kosnett patëm bisedë të çiltër dhe miqësore lidhur me situatën aktuale në Kosovë, sfidat me të cilat Kosova po ballafaqohet dhe domosdoshmërinë që partitë politike ta marrin përgjegjësinë për tejkalimin e sfidave", ka shkruar Kusari-Lila në llogarinë e vet në "Facebook".



# Kaçaniku bëhet gati për realizimin e projekteve për vitin 2019



**Kaçanik, 28 janar (ER)** - Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, dhe nënkryetari Ylber Bajra, kanë takuar të hënën ekzekutivin komunal në kuadër të mbledhjes së fillimjavës. Në këtë mbledhje nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave është bërë me dije se kompania e kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë ditëve të kaluara ka qenë në terren duke bërë pastrimin e rrugëve nga bora. Po ashtu, është bërë me dije se të gjitha rrugët në Kaçanik janë të kalueshme, por vështirësi qarkullimi janë paraqitur në zonat më të thella malore. "Gjatë ditës së diel kompania ka intervenuar edhe në fshatin Gjurgjedell ku, për shkak të erërave, janë formuar edhe ortekë të borës, e me këtë rast ka intervenuar kompania. Në vendet me ngrica dhe të rrezikshme është hedhur kripë dhe zhavorr. Edhe në këto çast kompania e kontraktuar nga komuna është në terren", ka njoftuar Komuna e Kaçanikut. Ndërsa zyrtarë nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit kanë theksuar se janë duke bërë përgatitjet finale të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2018. Në këtë mbledhje është bërë me dije se janë duke u bërë përgatitjet e planeve dhe të projekteve që do të realizohen gjatë vitit 2019.

# Prokuroria e Gjilanit brenda një jave ka ndaluar 13 persona të dyshuar

**Gjilan, 28 janar (ER)** - Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë javës së kaluar ka ndaluar 13 persona të dyshuar në kohëzgjatje prej 48 orëve për vepra të ndryshme penale. Departamenti për Krime të Rënda ka ndaluar gjashtë persona për shkak të dyshimit të veprave penale "Vrasje e rëndë", "Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm", "Armëmbajtje pa leje" dhe "Posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge".
Nga Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie janë ndaluar gjashtë persona për shkak të dyshimit të veprave penale "Lëndim i lehtë trupor", "Sulm" dhe "Shantazh". Ndërsa Departamenti për të Mitur ka ndaluar një të mitur për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" të KPRK-së.
Kjo prokurori për të gjitha rastet me ndalim, brenda afateve ligjore, ka parashtruar kërkesat për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente në Gjilan.



## Shtyhet seanca për rastin "Veteranët"

**Prishtinë, 28 janar** - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shtyrë mbajtjen e një seance që ishte paraparë të mbahet të hënën, në rastin e njohur në opinion si "Veteranët". Pjesë e këtij rasti janë 12 persona të cilët akuzohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Kryetarja e grupit gjykues, Nushe Kuka-Mekaj, ka thënë se seanca do të mbahet më 14 mars të këtij viti.
Arsyeja e shtyrjes së seancës ishte mungesa e ministrit të Mbrojtjes, Rrustem Berisha dhe Faik Fazliut, nga ish-Zyra e Kryeministrit për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
Në listën e personave të pandehur janë edhe Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhajdhe Xhavit Jashari.
Prokuroria Speciale e Kosovës, nga provat e siguruara deri më tani, ka vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar mbi 68 milionë euro.



Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Ekrem Mustafa, ka pritur në takim ministrin e Punëve të Brendshme të Maqedonisë Veriore, Oliver Spasovski

# Kosova e Maqedonia arrijnë marrëveshje për njohjen e patentëshoferëve

Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë Veriore kanë arritur marrëveshje për njohjen reciproke të patentëshoferëve. Nënshkrimi i marrëveshjes është bërë të hënën nga ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Ekrem Mustafa dhe nga ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Oliver Spasovski. Mustafa dhe Spasovski kanë nënshkruar edhe memorandumin për forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 28 janar** - Shteti i Kosovës dhe shteti i Maqedonisë Veriore të hënën kanë arritur marrëveshje për njohjen reciproke të patentëshoferëve. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Ekrem Mustafa dhe nga ministri i Punëve të Brendshme të Maqedonisë Veriore, Oliver Spasovski. Me këtë rast ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Ekrem Mustafa, ka thënë se ky bashkëpunim, përveçse do të jetë në të mirën e dy shteteve, do t'i shërbejë edhe sigurisë së përgjithshme në rajon. "Ka disa segmente ku ministritë tona të brendshme mund të bëjnë më shumë për qytetarët tanë, pikërisht me anë të marrëveshjeve dhe memorandumeve sikur këto që i nënshkruam", ka deklaruar ministri Mustafa.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Maqedonisë Veriore, Oliver Spasovski, ka vlerësuar se ky është një akt shumë i rëndësishëm nga i cili do të kenë dobi të madhe qytetarët e dy shteteve. "Ky proces ka filluar shumë kohë përpara dhe do të vazhdojë me kapitull të ri. Është një akt që do t'u sjellë lehtësira më të mëdha qytetarëve të dy shteteve. Gjatë realizimit të kësaj të drejte besojmë se ky hap do ta përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve tona", është shprehur ministri Spasovski.

Ministri Mustafa dhe Spasovski janë pajtuar për ta thelluar bashkëpunimin në mes dy vendeve sa i përket sigurisë, me ç'rast kanë nënshkruar edhe memorandumin për forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm. Po ashtu, ministrat e brendshëm kanë biseduar edhe për bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet dy institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, në veçanti kanë diskutuar për protokollin ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë për kryerjen e kontrollit kufitar në trafikun hekurudhor (Hani i Elezit/Bllacë).

# Mustafa kërkon zgjidhje nga Qeveria për përfundimin e grevave

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 28 janar** - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se është dëm i madh kur fëmijët fillojnë të mësohen ta humbin mësimin dhe kur pacientët shtrëngohen t'i durojnë sëmundjet e tyre, pa e ditur se kur do të përfundojnë grevat. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në këtë drejtim duhet të gjendet zgjidhje e menjëhershme. "Është dëm i madh kur fëmijët fillojnë të mësohen ta humbin mësimin dhe kur pacientët shtrëngohen t'i durojnë sëmundjet e tyre, pa e ditur se kur do të përfundojnë grevat. Konsideroj se duhet të gjendet zgjidhje e menjëhershme. Të sigurohet që pagat të jenë të njëjta për punë të njëjta dhe pagat të jenë në harmoni me kapacitetin buxhetor. Qeveria ka bërë veprime përmes të cilave ka hapur dyert që të gjithë të kërkojnë rritje të pagave", ka thënë Mustafa.

Ai ka thënë se nga njerëzit e këtij kabineti qeveritar është kritikuar se Qeveria nën drejtimin e tij ka lënë shumë borxhe për paga e mëditje, të cilat pastaj me vendimet e guximshme i ka kryer kjo Qeveri. "Diçka nga kjo është e vërtetë. Qeveria ime i mbeti borxh, para së gjithash, vetvetes. Vazhduam të punojmë me dyfish paga më të ulëta sesa tjerët. U angazhuam të ndërtojmë rregulla që pagat të mos caktohen me fushatë parazgjedhore dhe me vendime ad-hoc, por me ligj. Që rritja e pagave të shkojë proporcionalisht me rritjen ekonomike dhe që të përcaktohet sistemi i pagave të njëjta për punë të njëjta, ndryshe përfundojmë me krizë financiare si Greqia e para disa viteve. Por, për dallim se Greqia shfrytëzoi fondet e BE-së si anëtare, ne falimentojmë lehtë, sepse nuk jemi shtet anëtar i BE-së", ka deklaruar lideri i LDK-së.



Mustafa ka shtuar se pa marrë parasysh edhe sa ditë apo muaj i ka kjo Qeveri, të gjithë duhet të sillen racionalistë sa i përket arkës së shtetit dhe kërkesave për rritje të pagave. "Të punohet me FMN-në për kriteret, të bëhen analiza krahasuese me vendet në regjion dhe sistemi i pagave të përcaktohet me parime. Është dëm të pësojnë fëmijët, studentët, pacientët dhe qytetarët nga premtimet dhe mashtrimet gjatë fushatës dhe nga vendimet e pamatura", ka thënë Mustafa.

# Investitori i parë strategjik do të investojë 169 milionë euro për energjinë me erë




EPOKA E RE **A. MAVRAJ**

**Prishtinë, 28 janar** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, e ka konsideruar të arriturën më të madhe të Qeverisë së Kosovës aplikimin e 12 kompanive në vlerë prej afër dy miliardë eurosh për të investuar në Kosovë me Ligjin për Investime Strategjike. Ministri Shala ka bërë me dije se investitori i parë strategjik i ka përmbushur kriteret teknike për të kaluar në fazën tjetër të vlerësimit nga ana e grupit operacional që u themelua të hënën me vendim të grupit ndërministror. Shala ka theksuar se ky projekt do të prodhojë 105 megavat energji me erë. "Subjekti aplikues 'SowiKosovo LLC' planifikon të investojë 169 milionë euro për ndërtimin e parkut me erë në Komunën e Mitrovicës. Ky është investimi më i madh në Kosovë që nga pas lufta, i realizuar në fushën e investimeve në energji alternative. Parashihet ndërtimi i 30 turbinave me erë që do të prodhojnë 105 megavat energji elektrike. Deri tani kemi 12 aplikime me një vlerë të deklaruar afër dy miliardë euro. Kjo po bëhet me Ligjin për Investime Strategjike", ka thënë Shala, duke shtuar se kjo kompani i ka plotësuar të gjitha kriteret teknike të parapara me Ligjin për Investime Strategjike. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë qëndron e përkushtuar me dinjitet të lartë për përmbushjen e detyrave të saj, të cilat edhe janë objektiv i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Lutem që ky vit i zhvillimit ekonomik të shkojë kështu siç ka filluar dhe rinisë sonë t'i mundësohet punësim në vendin e vet", ka thënë ministri Shala. Ministri ka premtuar se do të përkushtohet maksimalisht me stafin që të sjellin sa më shumë investime në Kosovë. "Ju premtoj se do të jem i përkushtuar së bashku me gjithë stafin e MTI-së që sa më shumë të sjellim investime të huaja direkte në vendin tonë". Në fund të këtij takimi u formua komisioni operacional i cili do ta shqyrtojë edhe dokumentacionin si dhe plotësimin e kritereve nga investitori.

# Lansohet Fondi për Efiçiencë të Energjisë, Kosova e para në rajon

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe Zyra e Bankës Botërore në Kosovë, kanë lansuar të hënën Fondin për Efiçiencë të Energjisë Elektrike. Ky fond në fillim të operimit do të përfitojë 10 milionë euro grant nga Komisioni Evropian, 5 milionë euro nga Banka Botërore dhe 1 milion euro nga Qeveria e Kosovës




EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

**Prishtinë, 28 janar** - Të hënën është inauguruar Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë dhe bordi i drejtorëve ka filluar ditën e parë të punës me përbërje nga Ruzhdi Sefa, Lum Mita, Sazan Ibrahimi, Artan Berisha dhe dy përfaqësues nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore. Ky fond në fillim të operimit do të përfitojë 10 milionë euro grant nga Komisioni Evropian, 5 milionë euro nga Banka Botërore dhe 1 milion euro nga Qeveria e Kosovës. Përfituesit e këtyre projekteve do të jenë kryesisht ndërtesat publike dhe më vonë edhe ato private.

Shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova, ka thënë se ky është hap konkret për përmbushjen e agjendës evropiane të reformave dhe se energjia e Kosovës është prioritet i BE-së. "Ky është një hap konkret për përmbushjen e Agjendës Evropiane të Reformave. Kjo nuk do të ndodhte pa një punë të madhe dhe një koordinim të mirë në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Bankës Botërore dhe BE-së. Sektori i energjisë dhe reformat mbeten prioritet e BE-së. Efiçenca e energjisë është në thelb të këtyre reformave", ka thënë Apostolova.

Menaxheri i Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovanelli, ka theksuar se Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë është fondi i parë i tillë në Ballkanin Perëndimor dhe se kjo e bën Kosovën lidere në rajon në këtë fushë. Gjithashtu, Marco Mantovanelli ka thënë se ndihet i gëzuar që Banka Botërore është pjesë e këtij fondi dhe se do të kontribuojë edhe me asistencë teknike, e me përvojë nga fondet e tilla në pjesë të ndryshme të botës.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë, si entitet i rëndësishëm, i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, është themeluar me miratimin Ligjit për Efiçiencën e Energjisë për t'i arritur objektivat e Kosovës në këtë sektor. Lluka ka thënë se kanë ndërmarrë të gjitha veprimet sa i përket krijimit të strategjive për efiçencë. Ministri Lluka ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen financiare dhe asistencën teknike në këtë proces, Bankën Botërore si një partnere e vazhdueshme në këtë sektor si dhe të gjithë donatorët dhe institucionet e tjera financiare që në vazhdimësi po e mbështesin fushën e efiçencës së energjisë.

# Lluka dhe Balaj thonë se ristrukturimi i Telekomit është i domosdoshëm

Kryetari i Federatës Sindikale të PTK-së, Lahmi Balaj, është takuar të hënën me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Ata njëzëri kanë deklaruar se ristrukturimi i Telekomit është më se i domosdoshëm. Balaj ka thënë se njëherë duhet të bëhet ristrukturimi dhe investimet, pastaj mund të flitet për privatizimin



EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 28 janar - Kryetari i Federatës Sindikale të PTK-së, Lahmi Balaj, është takuar të hënën me ministrin e Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, me të cilin ka diskutuar për gjendjen në këtë ndërmarrje. Pas takimit ata kanë mbajtur një konferencë për medie, me ç'rast kreu i MZhE-së, Valdrin Lluka, ka thënë se është biseduar për ristrukturimin e kësaj ndërmarrje që, sipas tij, është një proces i domosdoshëm. Ministri Lluka ka theksuar se kërkesat e sindikatës do të merren parasysh, duke potencuar se është pro dialogut social në mënyrë që mos të anashkalohen kërkesat e punëtorëve. "Sot kishim një takim të përbashkët me sindikatën e Telekomit, me të cilën diskutuam për brengat që kemi dhe planin për vitin 2019, si dhe për fazat e ristrukturimit të kësaj ndërmarrje. Kjo fazë do ta marrë mbështetjen e Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim në mënyrë që punëtorët të ndihen komodë për procedurat që do të ndiqen. Ideja është që sindikata të jetë e përfaqësuar në vendimmarrje", është shprehur Lluka.

Edhe Lahmi Balaj nga Sindikata e Telekomit ka konfirmuar se janë pajtuar të bëhet ristrukturimi i Telekomit, duke e vlerësuar këtë hap të domosdoshëm. Ai ka treguar se ka dërguar disa lëndë te krimet ekonomike pasi, sipas tij, shumë kompani e kanë zhvatur Telekomin. I pyetur se si e ka pritur lajmin për mundësinë e privatizimit të Telekomit, Balaj ka theksuar se një herë duhet të bëhet ristrukturimi në këtë ndërmarrje, më pas të flitet për privatizimin. "Së pari duhet të flitet për ristrukturimin, më pas për investime dhe për privatizimin. Ne si sindikatë e kemi përkrahur ristrukturimin sepse Telekomi ka nevojë për një gjë të tillë. Ky ristrukturim do të përfshijë edhe sindikatën dhe sigurisht se ne do të jemi të zëshëm aty. Shqetësimet tona për Telekonin nuk kanë ndryshuar. Ato janë të njëjtat që kemi deklaruar më herët. Telekomi nuk është menaxhuar mirë. Nëse do të ndodhte një menaxhim i mirë nuk do ta kërkonim ristrukturimin. Telekomi është zhvatur nga kompani të ndryshme. Sot miliona euro janë shpërlarë nga këto kompani. Privatizimi i Telekomit nuk ka për të ndodhur njëherë përnjëherë. Po e përsëris, një herë do të ndodhë ristrukturimi. Unë personalisht jam kundër privatizimit", ka thënë Balaj.

# Reformat fiskale, hap i rëndësishëm për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë




Prishtinë, 28 janar (ER) - Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në vend ndikohet drejtpërdrejt nga avancimi i sektorit privat, dhe rrjedhimisht lehtësirat dhe reformat fiskale të ofruara në këtë drejtim janë kyçe për vazhdimin e rritjes ekonomike dhe stabilitetit makrofiskal. Kështu u theksua të hënën në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me ministrin e Financave, Bedri Hamza, mbi efektet e reformave fiskale në mjedisin e të bërit biznes në Kosovë.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se viti që kemi lënë pas ka shënuar një numër të madh reformash fiskale, të cilat kanë rezultuar me lehtësira për sektorin privat në Kosovë, po ashtu është reflektuar edhe në performancë të mirë të të hyrave. Ai bëri me dije se viti 2019 do të karakterizohet me vazhdim të reformave të tilla në drejtim të ndihmesës ndaj sektorit privat si dhe thjeshtësim të procedurave tatimore e jo ngarkesa dhe pengesa për bizneset.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se duke qenë një nga palët më të rëndësishme për sektorin privat, Ministria e Financave ka ndërmarrë një numër reformash fiskale gjatë vitit 2018 të cilat kanë ndikuar në zhvillimin dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të bizneseve, duke falënderuar ministrin Hamza për bashkëpunim në këtë drejtim.

## Ministri Reçica merr mbështetje nga kryeministri i Katarit

Prishtinë, 28 janar (ER) - Me ftesë të homologut të vet, ministrit të Zhvillimit Administrativ, Punës dhe Çështjeve Sociale, Yousuf Mohamed Al Othman Fakhroo, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, po qëndron për vizitë pune në shtetin e Katarit. Në një takim të përbashkët dy homologët kanë diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushat e punësimit dhe avancimit të mbrojtjes së kategorive të cenueshme si dhe temave të tjera sociale.

Gjatë qëndrimit në Doha të Katarit, ministri Reçica është pritur në takim edhe nga kryeministri i Katarit, Abdullah bin Nasser bin Khalifa Al Thani, nga i cili ka marrë përkrahjen për mbështetje në përpjekjet për përmirësimin e punësueshmërisë dhe në fushat e ngritjes së shërbimeve për kategoritë e cenueshme në Kosovë. Kryeministri Abdullah bin Nasser bin Khalifa Al Thani ka siguruar ministrin Reçica se Katari do të jetë përkrah Kosovës edhe në rrugëtimin e saj për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Ndërsa ministri Reçica ka shprehur nevojën që, krahas raporteve diplomatike, të punohet edhe për bashkëpunimin ekonomik mes vendeve tona, për çfarë edhe u pajtuan me kryeministrin Abdullah bin Nasser bin Khalifa Al Thani.



# MARRËVESHJA E PRESPËS, RAMIZI DHE UJI ‘ROSA’ DHE PEZULLIMI I TAKSËS!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Marrëveshja e Prespës:** Shqiptarët e ish-FYROM-it, tash Maqedonia e Veriut, kurrë nuk e kanë pasur një mundësi më të madhe se para votimit të Marrëveshjes së Prespës që t'i realizojnë të drejtat e munguara padrejtësisht dhe të cilat nuk i fituan as me luftën e armatosur. Këtë të drejtë dhe mundësi jo që nuk e realizuan, por e shpërdorën shkaku i një klase politike të ashtëzuar, të burokratizuar, të fosilizuar dhe përmbajtësisht të korruptuar; materialisht, politikisht dhe kombëtarisht! Me Marrëveshjen e Prespës shqiptarët e hëngrën karremin dhe efektet përfituese ishin dhe janë të natyrës kozmetike. Posti i kryetarit të Kuvendit ishte më herët dhe si shpërblim për rrëzimin e Gruevskit sikur edhe disa ministri, gjithashtu. Shqiptarët janë të përjashtuar nga pikat më të ndjeshme të pushtetit sikur që janë ato informative dhe kundër informative ndërsa, ato poste që i kanë, në çdo kohë mund të bllokohen nga shumica në pushtet politikanët maqedonas, dhe sidomos nëse nesër vjen në pushtet VMRO-ja apo ndonjë parti radikale maqedonase. Para votimit të Marrëveshjes së Prespës, shqiptarët e patën topin në pikën e 11-shës, me portën thuaja pa portier maqedonas dhe pikërisht kur u desh të shënonin, jo që nuk shënuan në golin e kundërshtarit, por shënuan autogol! Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, deri në votimin e Marrëveshjes së Prespës, ishin kartë e fuqishme e Kosovës për shkak të potencialit destabilizues në rajon, në të gjitha negociatat, për faktin se rezultati i shumë negociatave në Ballkan përcaktohet nga kapaciteti destabilizues sipas parimit se kush destabilizon, mund edhe të stabilizojë. Shqiptarët në Ballkan janë të pashembullt sa i përket sakrificës së bërë e që nuk e ka bërë asnjë popull në Ballkan, por janë humbës kur politikisht duhet ta mbrojnë dhe materializojnë këtë sakrificë.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës u shërbyen ndërkombëtarëve deri në momentin kur u rrëzua Millosheviqi dhe u dërgua në Burgun Sheveningen të Hagës. Pas kësaj u hoq Zona e Sigurisë prej pesë kilometrave dhe filloi dhuna e aparatit shtetëror serbë ndaj tyre e që vazhdon deri më sot. Asgjë nuk përfituan përveç intensifikimit të shpërnguljes, mohimit të të drejtës për dokumentacion identifikues dhe tjetër dhe futja në lista për arrestim për shkak të pjesëmarrjes në luftë.

Shqiptarët e Malit të Zi, me votat e tyre përcaktuan fatin e referendumit për ndarjen e Malit të Zi nga Jugosllavia e Zhablakut, me premtime se të drejtat e tyre do të rregullohen me "ligje demokratike" kurse sot ndiqen dhe dënohen për shkak të përdorimit të flamurit kombëtar! Shqiptarët e Malit të Zi janë keqpërdorur nga pushteti malazias i cili, sot, nuk dallon fare nga ai i mëparshmi.

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kontribuuan ta rrëzojnë Gruevskin ndonëse BDI ishte e gatshme ta nënshkruaj një marrëveshje të re me Gruevskin dhe vetëm ndërkombëtarët, pak para nënshkrimit të marrëveshjes e penguan këtë për t'i hapur rrugë Zaevit që nuk bëri ndonjë punë të madhe për shqiptarët përveçse vazhdon t'i përdorë ata politikisht, çdo herë kur ka nevojë. Marrëveshja e Prespës ishte i fundit dhe shembull konkret i papjekurisë politike të klasës së korruptuar shqiptare në Maqedoni të Hamamit të Hyrës, Veriore apo çfarëdo qoftë ajo! Për shqiptarët e Maqedonisë, më me rëndësi ka qenë Kosova se vet Shqipëria për shkak se për shumë gjëra e kanë pasur fatin e njëjtë. Tash, në rrethanat e krijuara, me hyrjen e Maqedonisë së Veriut në NATO, roli dhe rëndësia e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut vetëm sa do të relativizohet dhe, herët a vonë do ta pësojnë fatin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe atyre në Mal të Zi. Madje, për shkak të ndikimit të madh të fesë, në dëm të interesave kombëtare, shqiptarët në Maqedoni e kanë më të lehtë procesin e dekompozimit politik dhe kombëtar. Kësaj i ndihmon shumë edhe largimi i tyre nga Maqedonia për shkak të papunësisë dhe mungesës së programeve zhvillimore e që janë të drejtuara kryesisht në rajonet e populluara me shumicën maqedonase. Nuk vjen shpesh rasti kur mund ta materializoni një mundësi historike siç e patën shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, para votimit për Marrëveshje të Prespës e që aq lehtësisht e lëshuan duke ia dobësuar në këtë mënyrë shumë edhe pozitën negociuese të Kosovës. Kujtojeni Marrëveshjen e Ohrit; kur duhej që ajo të zbatohej, autoritetet maqedonase thoshin se ka humbur origjinali i kësaj marrëveshjeje!!!

**Ramizi dhe uji "Rosa":** Ramiz Kelmendi, një tajkun kosovar, nuk ka lënë parti politike pa shkuar dhe pa fituar postin e deputetit, që nga AAK-ja, PDK-ja e deri te LDK-ja. Tash i kanë mbetur ta provojë fatin vetëm te LV-ja e cila, së paku, sipas deklaratave publike e ka anatemuar dhe në Lista Srpska që, deri në këtë çast e ka pezulluar aktivitetin në Qeveri dhe Kuvend të Kosovës ndonëse marrin paga të majme dhe i shfrytëzojnë të gjitha veturat zyrtare e që nuk do të lejonte asnjë shtet normal. Me vendosjen e taksës 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja u rrezikuan disa tajkunë që perandorinë e pasurisë së tyre e kishin ngritur me mallra serbe dhe duke pastruar parat e tajkunëve nga Serbia dhe Bosnja, duke filluar nga Mishkoviqi i Serbisë e deri te Dodigu i Bosnjes që zotërojnë shumë biznese në Kosovë përmes tregtarëve të papërgjegjshëm dhe pandërgjegjshëm kosovarë. Me rritjen 100 për qind të taksës për këto mallra, ranë edhe të hyrat e tajkunëve kosovarë që janë të zhveshur nga çdo skrupull apo ndjenjë e përgjegjësisë kombëtare dhe njerëzore. Fillimisht, për shkak të mungesës së informatave se si do të sillej faktori ndërkombëtar për taksën e sidomos amerikanët, një pjesë e këtyre tajkunëve të ligë u strukën dhe madje e përkrahën taksën me shpresë se kjo taksë do të hiqej shpejt e që nuk ndodhi. Me kalimin e kohës dhe me kërcënimin e hapur të dy burokratëve mashtrues dhe gënjeshtarë që i mashtruan qytetarët e Kosovës për viza; Johanes Han dhe Frederika Mogerini, filluan të ngrenë kokë një pjesë e tajkunëve të Kosovës por, jo aq zëshëm sepse mungonte një qëndrim i prerë amerikan. Kur edhe amerikanët, përkatësisht letrës shantazhuese dhe shumë të dëmshme për Kosovën të presidentit Tramp kërkuan heqjen e kësaj takse, tajkuni Kelmendi doli botërisht kundër kësaj takse, jo se e dëmton Kosovën por se qenka kërkesë e miqve amerikanë! Tash, kur ambasada e ShBA-ve doli me një kërcënim eksplicit për heqjen e taksës duke përmendur pasojat e mundshme, tajkuni Kelmendi, si të ishte vet Pompeo, doli me një kërkesë të prerë se duhet të hiqet kjo taksë. Kjo ndodhi para dy ose tre ditëve përmes një interviste në njërin nga televizionet e Kosovës. Më bëri përshtypje që ishte ulur në një fotele të përmasave gjigante, mbase në përputhje me peshën trupore e sidomos pasurisë që e ka. Por, më shumë përshtypje më bëri se në tavolinën e punës e kishte një shishe me ujë. Ju lexues të nderuar do të mendoni se ishte shishe me ujë Rugove apo Akulli ose, qoftë të ndonjë brendi tjetër vendor. Po tajkuni Kelmendi është jashtëzakonisht inteligjent, pragmatik dhe praktik; po të kishte ujë të prodhimit vendorë, do të binte në kundërshtim logjikë me kërkesën e heqjes së taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnja prandaj, që kjo kërkesë të jetë më bindëse, përveç thirrjes te miqtë amerikanë, mbi tavolinë e kishte një shishe me ujë "Rosa", ujë nga Serbia e që me të madhe shitet në Kosovë duke dëmtuar prodhuesit vendorë! Kështu, tajkuni Ramiz "Rosa" vetëm po tregon vartësinë patologjike nga mallrat prej Serbisë dhe Bosnjës, fillimisht me ujin "Rosa" e pastaj me të gjitha mallrat që prodhohen në këto dy shtete armiqësisht të disponuara ndaj Kosovës e që në Kosovë eksportojnë mbeturinat e mallrave të tyre e që nuk zënë vend në kontejnerët e mbeturinave në këto dy shtete!

**Pezullimi i taksës, shkrirja e borës dhe dallimi midis skllotës dhe të bërit punën m.t:** Ka shumë presion për heqjen e taksës 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Të gjithë janë ngritur në këmbë, nga Vuçiqi, presidenti çetnik i Serbisë, spastruesi i certifikuar në baza etnike, Dodigu i Bosnjës, dyshi mashtrues dhe gënjeshtarë, Johanes Han dhe Frederika Mogerini, Makroni i Francës, Kuraci i Austrisë dhe të tjerë sikur edhe Donald Tramp, presidenti amerikan janë të paluhatshëm në kërkesën për heqjen e taksës. Çdonjëri nga ta po kërcënon me pasoja. Jo për shkak të dëmeve që po i bëhen Serbisë dhe Bosnjës por shkaku se nuk ka vazhdim të bisedimeve për faktin se për vazhdim të bisedimeve të pakushtëzuara deri më tani, Serbia po e kushtëzon vazhdimin e bisedimeve me heqjen e taksës. Heqjen e taksës e ka kërkuar edhe presidenti Thaçi duke u thirrur, sikur edhe tajkuni Kelmendi në kërkesën e miqve amerikanë, "gocat mashkullore" të LDK-së dhe disa analistë kosovarë, krejtësisht të varur nga pavarësia e nënshtrimit dhe injorancës! Madje, presidenti Thaçi, si njeri shumë i lexuar dhe si kontribuues konkret i dy librave bestseller për veten e tij, edhe në këtë rast, duke i dërguar një porosi të qartë kryeministrit Haradinaj për heqjen e taksës, përmes shkrimit letrar, metaforave dhe alegorive, këtë kërkesë e formuloi se "uron që shkrirja e borës të mos e bëjë punën sklotë......". Realisht, pas shkrirjes së borës, si në Kosovë, Serbi, Arktik, Siberi, Kanada apo edhe në Amerikë, shkrirja e borës e prodhon skllotën si diçka të pashmangshme. Këtë nuk mund ta demantojë, në aspektin meteorologjik as Sylë Tahirsylaj, me atë pajisjen që e mbanë me vete gjithmonë kur e

→

parashikon motin për 100 vjetët e ardhshëm. Unë nuk kam kapacitet intelektual e sidomos letrar për t'i kuptuar këto porosit letrare që Hashim Thaçi ia dërgoi Ramushit sikur që e bëri në mënyrë shumë spirituoze këshilltari i Ramushit, Halil Matoshi që nuk e zgjodhi rrugën e konfrontimit me Hashimin por ia lëshoi në shpinë një poezi të Dom Ndre Mjedës. E tash le të konfrontohet Hashimi me Ndre Mjedën?! Nëse është ai Mjeda që ka polemizuar me Gjergj Fishtën me një fjalor aspak apostolik atëherë Hashimi do të ndahet i deklasuar fare! Më tha një mik imi; ç'flet marrëzira, po Ndre Mjeda është i vdekur fare dhe moti! Përgjigja ime ishte se edhe Hashim Thaçi është i vdekur politikisht, apo se është në vdekje klinike prandaj edhe debati ka kuptim në mes dy të vdekurve!

Tash po del se taksa 100 për qind për mallra nga Serbia dhe Bosnja po përdoret politikisht nga Vuçiqi dhe Thaçi për vazhdim të bisedimeve dhe arritjen e një marrëveshjeje hist(e)orike që po përkrahet aq shumë nga ndërkombëtarët hiç këtu Gjermaninë që po e kundërshton lojën me kufij e që aq shumë po e përkrahin BE, presidenti Tramp me këshilltarin për Siguri, z, Bolton dhe të cilën marrëveshje nuk e kundërshton fare as "demokrati" Putin! Kosova, deri më sot nuk e ka kushtëzuar me asgjë dialogun me Serbinë por ka pranuar çdo gjë që ka kërkuar Serbia. Jam i bindur se Trampit, nëse deri atëherë mbijeton qëndrimin në pushtet, nuk i ha aspak palla për kufijtë e Kosovës prandaj edhe po e përkrahë korrigjimin e tyre. Edhe Hashim Thaçi, president fort po i bie këtij kavalli të korrigjimit të kufijve. Realisht, të gjithë ata që flasin për korrigjim të kufijve, thërrasin për luftë, gjak dhe viktima të reja . Është detyrim njerëzorë, politik, kombëtar dhe moral që të kundërshtohet kjo luftënxitje dhe të kërkohet një zgjidhje brenda kufijve ekzistues. Asgjë më shumë! Nëse Serbia paska të drejtë të kushtëzojë vazhdimin e dialogut me Kosovën pse atëherë Kosova mos ta ketë këtë të drejtë?! Prandaj, po të isha në vend të kryeministrit Haradinaj, menjëherë do ta hiqja taksën ndaj Serbisë dhe Kosovës kurse vazhdimin e dialogut me Serbinë do ta kushtëzoja me ndriçimin e fatit të personave të pagjetur apo edhe me 100 mijë arsye tjera. Ose duhet të ketë bisedime të pakushtëzuara ose kushtëzimi duhet të jetë reciprok! Mllefi ndaj kryeministrit Haradinaj nuk është për taksën 100 për qind por pse nuk po kanë mundësi të takohen Thaçi dhe Vuçiq për një marrëveshje historike! Prandaj, nuk janë të rastit presionet që po i bëhen Ramush Haradinaj, duke filluar nga ato ndërkombëtare e deri te tajkuni Kelmendi dhe skllota e borës e poetit të shquar Hashim Thaç Khajami! Nuk janë të rastit as grevat e mirorganizuara ku, përveç 40 mijë veteranëve mashtrues dhe hajdutë, edhe afërsisht 65 mijë nëpunës zyrtarë dhe shërbyes civilë po kërkojnë rritje të pagave! Ramush Haradinaj i ka dy mundësi apo zgjidhje; t'i nënshtrohet ko... mëdhenjve për heqje të pakusht të taksës apo grevistëve që, si duket po dirigjohen nga një qendër politike! Nuk është e rastit që edhe Gjykata Speciale po fton aq shumë dëshmitarë të dyshuar, si t'i ftonte për vaksinim nga gripi sezonal e jo për vepra të rënda penale! Për mbrojtje të kufijve të brendshëm, sidomos për bashkimin e Mitrovicës të gjitha shpresat i kam te Agim Hasan Prishtina, një politikan i pakompromis për çështje kombëtare, një moralist i shquar, një stoik modern, dhe një erudit i njohur Ndërkaq, sa i përket heqjes së taksës 100 për qind kam dëgjuar se Ramushi moti e kishte hequr po të mos ishte babai i taksës dhe kundërshtari më i fuqishëm për heqjen e saj, zëvendëskryeministri i dytë, i pari është Begj Pacolli, Enver Hoxhaj që po kërcënon se në asnjë kusht dhe në asnjë rrethanë nuk e pezullon taksën madje edhe nëse shkon koka e... Ramushit. Unë, duke e ditur vendosmërinë për mbajtje të fjalës së dhënë, respektimin e besës tradicionale, të përkushtimit tredimensional, ndjenjës së lartë për sakrificë deri në flijim të të tjerëve, sinqeritetin dhe seriozitetin e zëvendëskryeministrit Hoxhaj, nuk gjasa të hiqet taksa 100 për qind sepse, edhe pa ADN-në, atësia e vendosjes së taksës është e Enver Hoxhaj kurse mëmësia është e Endrit Shalës: Kosova seriozisht po rrezikohet, jo pse shkrirja po e bënë skllotë por pse me korrigjimin e kufijve punën e kanë bërë m.t, Hashimi me kotillën e vet politike, vendore dhe ndërkombëtare. Kur na ka rrezikuar dhe sulmuar Serbia, jemi mobilizuar dhe jemi bashkuar duke u mbrojtur me sakrifica biblike sikur që na kanë përkrahur dhe mbrojtur edhe ndërkombëtarët. Tash, kur po e sulmojmë dhe po e shkatërrojmë veten tonë askush nuk mundet dhe nuk do ta mbrojë nga vetja jonë. Do të isha i lumtur nëse gaboj për këtë parashikim!

# Lojë matrapazësh për përfitime personale në kurriz të pensionistëve

## - Reagim ndaj një informate të përhapur në disa portale, me titull "Koha që Serbia t'i kthejë pensionet në Kosovë"



SYLEJMAN KRASNIQI

Në fillim të dhjetorit (më 02.12.2018) në disa portale ("Telegraf.com"; "rtklive.com", "Epoka e re" etj.) njëfarë Sylejman Meta (i vetëquajtur kryetar i Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës) bën "premtimin e fundit" se do t'ua nxjerrë pensionet nga Serbia pensionistëve të paraluftës të Kosovës. Ai thotë se "…kanë arritur që ta marrin listën e pensionistëve kosovarë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale" dhe atë do ta dërgojnë atje ku "duhet", pra në Serbi.

Pasi që z. Sylejman Meta është paraqitur në opinion nën çadrën e "Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës", ne, Kryesia e Federatës Sindikale të Pavarur të Pensionistëve, të Invalidëve të Punës dhe të Moshuarve të Kosovës, e shqyrtuam në forumet tona këtë informatë dhe po dalim me këtë reagim:

Nuk e besojmë që MPMS-ja të bjerë në kësi kurthe e t'i japë listat e pensionistëve individëve të papërgjegjshëm. Nëse kjo është e vërtetë, këto lista i kanë marrë nga zyrtarë të pandërgjegjshëm dhe nga nëntoka, e kurrsesi në rrugë zyrtare. Këtë gabim nuk mund ta bëjë MPMS-ja sepse ky nuk është detyrim i individëve e as i organizatave joqeveritare, por është detyrim zyrtar dhe shtetëror i Kosovës.

Z. Meta thotë se është në kontakt me Avokatin e Popullit në Serbi, me Gjykatën Supreme dhe me Fondin Pensional të atij shteti. Krejt natyrshëm rrjedhin pyetjet:

Kush e autorizoi z. Meta për ta kontaktuar Avokatin e Serbisë dhe me të gjitha këto institucione të Serbisë? Në çfarë cilësie i ka zhvilluar dhe i mbanë këto kontakte me institucionet e Serbisë? Argatin e kujt po e bën Sylejman Meta?

Jemi shumë të sigurt se nuk e bën argatin e sindikalistëve pensionistë të Kosovës. Edhe para disa vjetëve disa individë janë marrë me kësi skema mashtrimi në kurriz të pensionistëve. Të gjitha ato kanë dështuar, por matrapazët i kanë mbushur xhepat e tyre duke i marrë nga 2-3 euro prej secilit pensionist.

Gjykatën e Strasburgut z. Sylejman Meta e përdor si vegël mashtrimi për pensionistët. Gjykata e ka dhënë një mendim për pensionet e Kosovës të rrëmbyera nga Serbia por, sa kemi njohuri ne për këtë, ajo gjykatë jep vetëm mendim e nuk e ka fuqinë e detyrimit ndaj Serbisë për t'ua kthyer pensionet shqiptarëve të Kosovës.

Z. Sylejman Meta thotë se listat e pensionistëve i ka marrë nga MPMS-ja dhe se ato do t'ua dërgojë institucioneve përkatëse të Serbisë(!), por thotë se pensionistët duhet të paraqiten individualisht me kërkesa pranë organeve serbe.

Z. Meta thotë se do të takohet edhe me kryekuvendarin Kadri Veseli në mënyrë që të gjejnë një formë "mashtrimi" për Serbinë që ato pensione të mos quhen me emrin e vërtetë, por të quhen "ndihma sociale e pensionistëve". A po e di se çfarë po pështjellon ky Sylejmani Meta me veten e tij dhe në dëm të pensionistëve?

Opinioni në Kosovë e di shumë mirë se çdo kërkesë e qytetarëve të Kosovës në institucionet e Serbisë do të keqpërdoret nga Serbia e cila do t'i konsiderojë ata (pra paraqitësit e kërkesave) si qytetarë lojalë të Serbisë.

Prandaj Federata Sindikale e Pavarur e Pensionistëve, Invalidëve të Punës dhe e të Moshuarve të Kosovës (FSP-PIPMK) u bënë thirrje pensionistëve që të mos paraqiten individualisht për këto pensione tek matrapazët ordinerë sepse pensionet, nëse mund të nxirren, ato mund dhe duhet të kryhen vetëm në rrugë zyrtare, me marrëveshje mes shteteve, e kurrsesi me ndihmën e mesitëve matrapazë. Federata Sindikale e Pensionistëve të Kosovës do të jetë përherë në kontakt me BSPK-në dhe, nëpërmjet saj, me Qeverinë dhe do t'ju njoftojë me kohë për çdo lëvizje për këtë çështje.

**Për Federatën Sindikale të Pavarur të Pensionistëve, të Invalidëve të Punës dhe të Moshuarve të Kosovës**
**Kryetari: Sylejman Krasniqi, Prishtinë**

## Merkeli i dhuron Rusisë 12 milionë euro



BERLIN, 28 JANAR - Berlini dhe Moska njoftuan se Gjermania ka dhuruar 12 milionë euro për t'i ndihmuar veteranët e Luftës së Dytë Botërore, por Moska tha se shuma nuk është e mjaftueshme. Njoftimi erdhi pasi Rusia shënoi 75-vjetorin e përfundimit të rrethimit të Leningradit, Shën Petersburgut të sotëm. Mediet ruse raportojnë se vendimi u mirëprit nga ministrat e jashtëm të Rusisë, Sergey Lavrov dhe Gjermanisë, Heiko Maas. "Ne, ministrat e jashtëm të Gjermanisë dhe Rusisë, mirëpresim vendimin e Qeverisë gjermane, bazuar në pranimin e përgjegjësisë për krimet në ato vite që ka kryer Gjermania, për të treguar një gjest vullnetar njerëzor për viktimat e rrethimit të cilët ende janë gjallë", thuhet në deklaratën e dy ministrave.

Donacioni prej 12 milionë eurosh do të përdoret për modernizimin e spitaleve për veteranët e luftës dhe themelimin e qendrës gjermano-ruse. Lavrov dhe Maas janë të bindur se ky gjest do të kontribuojë për përmirësimin e standardeve të jetesës së viktimave të rrethimit dhe do t'i shërbejë pajtimit historik ndërmjet popujve të të dyja vendeve, i cili është thelbësor për marrëdhëniet dypalëshe në të ardhmen.

# ShBA-ja paralajmëron Venezuelën për kërcënimet ndaj diplomatëve

Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, John Bolton, ka paralajmëruar Venezuelën se çdo kërcënim kundër diplomatëve amerikanë apo liderit opozitar Juan Guaido do të përballet me përgjigje të fuqishme



Carlos Garcia Rawlins (Reuters)

UASHINGTON, 28 JANAR - Shtetet e Bashkuara kanë paralajmëruar Venezuelën se çdo kërcënim kundër diplomatëve amerikanë apo liderit opozitar Juan Guaido do të përballet me "përgjigje të fuqishme". Këshilltari amerikan për Siguri Kombëtare, John Bolton, ka thënë se çdo lloj i presionit nënkupton "sulm të rëndë në sundimin e ligjit".

Paralajmërimet e tij kanë ardhur disa ditë pasi ShBA-ja dhe rreth 20 shtete të tjera kanë njohur Guaidon si president të përkohshëm të Venezuelës. Ndërkohë, Guaido ka bërë thirrje për protesta kundër qeverisë në ditën e mërkurë si dhe të shtunën. Guaido, lider opozitar, ka shpallur veten president të përkohshëm më 23 janar.

Kriza politike në Venezuelë duket se ka arritur në pikën më të nxehtë pasi janë shtuar përpjekjet për ta larguar nga pushteti presidentin e kontestuar, Nicolas Maduro. Ai është betuar në mandatin e dytë në këtë pozitë më herët gjatë këtij muaji, ndonëse zgjedhjet që ka fituar ai janë bojkotuar nga opozita dhe janë kritikuar nga faktori ndërkombëtar.

Të dielën përfaqësuesi më i lartë i ushtrisë së Venezuelës në ShBA, Jose Luis Silva, ka ndryshuar qëndrim, duke thënë se njeh Guaidon si president. Më vonë, Bolton ka rithkesuar pozicionin e Uashingtonit dhe ka bërë thirrje kundër dhunës.

### Kush është mbështetës i Maduros?

Ndonëse ShBA-ja mbështet Guaidon në Venzuelë, Rusia, Kina, Meksika dhe Turqia janë rreshtuar përkrah Maduros. Në një takim të mbajtur në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të shtunën, Rusia ka akuzuar Uashingtonin për organizim të puçit. Megjithatë, dhjetëra shtete të Amerikës Latine dhe Kanadaja kanë mbështetur Guaidon si president. Në Evropë, partia në pushtet në Greqi, ka treguar mbështetje të hapur për Maduron.

### A po i ndihmon Kremlini Maduros?

Kremlini ka hedhur dyshime në një raport që pretendon se 400 kontraktorë ushtarakë privatë të Ushtrisë ruse janë nisur në Venezuelë për t'i ndihmuar presidentit të kontestuar, Nicolas Maduro, që ta forcojë sigurinë në këtë shtet.

Duke folur në një emision javor në televizionin rus "Rossia-1", zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, është pyetur: "A janë duke ruajtur 400 luftëtarë tanë Maduron në Venezuelë apo jo?" Ai është përgjigjur me një shprehje ruse: "Frika ka 100 palë sy", duke lënë të kuptohet se shifrat janë rritur apo se nuk janë të vërteta, megjithatë nuk i është përgjigjur drejtpërdrejt pyetjes. Peskov më parë ka thënë se nuk ka informacione lidhur me raportin e agjencisë së lajmeve "Reuters" për luftëtarët rusë në Venezuelë. Disa burime i kanë thënë kësaj agjencie se bashkëpunëtorët janë të lidhur me një grup të ashtuquajtur Wagner, i cili përbëhet nga personeli rus, që është përfshirë në operacione në shtete të huaja.

Udhëheqësi i Asamblesë së ashtuquajtur Zyrtarët e Gjithë Rusisë, e cila ka lidhje me bashkëpunëtorët e lidhur me Ushtrinë ruse, ka thënë se ka dëgjuar që 400 luftëtarë rusë mund të jenë në Venezuelë, ndonëse burime të tjera kanë përmendur shifër më të vogël. Përndryshe, bashkëpunëtorët privatë të Ushtrisë ruse është raportuar të kenë vepruar edhe në shtete të tjera, përfshirë Sirinë, Ukrainën dhe kombet afrikane.

### Pse ka nisur pakënaqësia në Venezuelë?

Venezuela është duke u përballur me krizë ekonomike, hiperinflacion dhe zvogëlim të rezervave kryesore të gjërave thelbësore për jetesë, çka ka shtyrë miliona persona të largohen nga vendi i tyre. Maduro është përballur me opozitë të brendshme dhe kritika ndërkombëtare lidhur me menaxhimin e të drejtave të njeriut si dhe ekonomisë.

# Ish-shefi i Starbucks mund të garojë për president të ShBA-së



UASHINGTON, 28 JANAR - Ish-shefi ekzekutiv i zinxhirit të restoranteve të kafesë Starbucks tha se po e shqyrton seriozisht kandidimin për president të Shteteve të Bashkuara.

Howard Schultz, i cili ka dhënë dorëheqje nga posti në Starbucks vitin e kaluar, tha se po konsideron të garojë si kandidat i pavarur i qendrës në vitin 2020.

Në disa postime në "Twitter", Schultz tha se dy partitë më të mëdha politike në ShBA janë më të ndara se kurrë. "Le të diskutojmë se si mund të bashkohemi për të krijuar mundësi për më shumë njerëz", tha ai.

Në një intervistë për CBS-in, Schultz tha se ka qenë demokrat i përjetshëm, por e kritikoi sistemin aktual të dominuar nga dy parti. Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, iu përgjigj komenteve të tij me një postim në "Twitter", duke thënë se "Schultz nuk e ka guximin për të garuar për president".

## ShBA-ja arrin marrëveshjes me talebanët



KATAR, 28 JANAR - Negociatorët amerikanë dhe përfaqësues të talebanëve kanë rënë dakord mbi draftin e marrëveshjes së paqes, që kërkon t'i japë fund konfliktit 17-vjeçar në Afganistan. Gjashtë ditë bisedime zhvilluan amerikanët me militantët afganë në Katar javën e kaluar.

Presidenti i Afganistanit kishte drejtuar një apel të ri për negociata të drejtpërdrejta me grupin islamik, por deri tani ishte refuzuar, ndërsa ekzekutivi i tij cilësohej një "qeveri kukull". Grupi, që ka sunduar vendin nga viti 1996 deri më 2001, mbetet forca kryesore rebele atje. Qeverisja e tyre mori fund pas pushtimit të Afganistanit nga Shtetet e Bashkuara, në vazhdën e sulmeve të 11 shtatorit. Al Kaeda përdori pikërisht shtetin e varfër, si bazë për ta organizuar goditjen e Amerikës në zemër të saj.

Administrata e Donald Trumpit po shikon mundësinë e tërheqjes së trupave amerikane nga Afganistani, ndërsa talebanët kanë dhënë në këmbim garanci, se asnjë grup ndërkombëtar terrorist nuk do të lejohet ta përdorë terrenin afgan për të kërcënuar në të ardhmen Amerikën, apo vende të tjera.

# MBRESA NGA LEXIMI I NJË LIBRI

("Mbresa nga Stambolli dhe Bursa" (udhëtim studimor me studentë), Libri Shkollor, Prishtinë, 2018, të autorëve bashkëshortë: prof. dr. Tefik Basha & prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha)



Mr. Shefki STUBLLA

Kjo vepër i kushtohet një udhëtimi studimor me studentët e Fakultetit të Edukimit në Gjilan e Prishtinë, në krye me prof. dr. Tefik Basha (gjeografi) dhe prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha (historiane). Qëllimi i vizitës ishte: njohja e studentëve me gjeografinë dhe historinë, fusha këto shumëfish të lidhura me trojet dhe me popullatën shqiptare.
Pas leximit të këtij libri studimor ndjeva një kënaqësi dhe nderim të veçantë, kur bashkëshortët Basha, këtë udhëtim, me këtë libër e bënë që të mos harrohet takimi njerëzor e prindëror me shqiptarët e shpërngulur me dhunë nga Kosova në Turqi, para e mbas LDB-së.
Kam përshtypjen se ky libër do të lexohet me ëndje jo vetëm nga studentët, protagonistët e këtij udhëtimi, por edhe nga të tjerët. Kjo trajtë e rrëfimit është "vek për yrnek", siç do të thoshte Mehmet Halimi.
Personalisht më pëlqeu thurja e këtij teksti interesant me shembuj konkretë në këtë ditar udhëtimi në një vend të huaj, sidomos kënaq qasja pedagogjike e profesorëve - edukatorëve Basha, si model bashkëpunimi me studentë, të cilët në çdo çast konsiderohen si partnerë.
Tregimi nga kjo rrugë, ky ditar udhëtimi, edhe mua më bëri për vete. Sikur edhe unë isha student dhe udhëtoja për Turqi. Sidomos më pëlqeu motivi i inspiruar nga shkrimtari i njohur hebre, Amos Oz, për të shkruar këtë libër.
Ky libër, që nga hyrja e deri në mbarim, afron dhe josh lexuesin, e informon atë për shumë ngjarje që i ndodhën popullit tonë gjatë historisë dhe mbijetesës së tij nga shumë okupatorë.
Ky libër mund të merret ose të konsiderohet edhe si ciceron turistik për ata që vizitojnë Stambollin dhe Bursën në Turqi.
Po ashtu, edhe si libër gjeografie dhe historie për këto dy qytetet. Është libër që freskon mendjen. Nga ky lexuesi nxjerr shumë mësime.
Më la përshtypje përshkrimi i qytetit Bursa, të cilin e kam vizituar edhe unë dikur, por pas njohjes me të rejat që më ofroi libri u kënaqa edhe më shumë: se ky ishte kryeqyteti i parë i shtetit osman, i pasur me shumë monumente kulture dhe arkitekture, sidomos ura Ingardi, me dyqane dhe me Jeshil Xhaminë.
Një mrekulli tjetër e këtij libri është takimi me shqiptarët e vendosur në Bursa si muhaxhirë të ndjekur me dhunë nga trojet e veta të Kosovës. Sidomos fakti kur këta ende e flasin gjuhën e nënës - shqip, sidomos kur ata dëshmojnë se janë shqiptarë. Po ashtu, më preku shumë rrëfimi i tyre në gjuhën shqipe, sidomos rrëfimi i Selimit, nga fshati Laçiq i Dardanës (ish-Kamenica) dhe shumë gjëra të tjera me këtë temë të dhimbshme dhe të ndjeshme.
Ky udhëtim juaji, përveç njohurive nga gjeografia dhe nga historia, është një punë e vlefshme bërë atyre shqiptarëve nga Kosova, të vendosur atje pa dëshirë, prej të cilëve ka ende që nën jastëk mbajnë një grusht dhe nga atdheu dhe të vetmet ëndrra që shohin janë për vendlindjen e tyre.
Po ashtu u gëzova shumë kur lexova se nga shqiptarët e vendosur atje ka shumë talent në fushën e kulturës dhe të artit. Dhe në fushat tjera të jetës. Madje, që Grupi i valltarëve shqiptarë nga Bursa,që shfaqen program për studentet nga në akademinë ushtarake studentët shqiptarë pranohen pa provim pranues.
Më preku shumë takimi me valltarin e mirënjohur në Turqi - Hakiut, me dajën e tij nga Karaqeva. Ose takimi me kryetarin e rinisë së partisë AK, që ishte me origjinë nga Doberçani, që enkas për studentët e Gjilanit ishte kthyer nga një udhëtim zyrtar vetëm të takohej me anasit e vet. E dhembshme ishte kur ai nuk dinte të fliste shqip, ama këngën "Oj Kosovë, oj nëna ime..." e këndoi duke qarë.




## Grupi i valltarëve i shoqatës shqiptare nga Bursa, shfaqen program për studentet nga Kosova

Më preku shumë takimi me valltarin e mirënjohur në Turqi - Hakiut, me dajën e tij nga Karaqeva. Ose takimi me kryetarin e rinisë të partisë AK, që ishte me origjinë nga Doberçani, dhe enkas për studentët e Gjilanit ishte kthyer nga një udhëtim zyrtarë vetëm e vetëm që të takohej me anasit e vet. E dhembshme ishte kur ai nuk dinte të fliste shqip, ama këngën " Oj Kosovë , oj nëna ime..." e këndoi duke qarë që vaji më vonë për tu përhap në tërë grupin e studentëve aty diku pas orës një të natës.
Po ju drejtohem koautorëve të këtij libri, profesorëve Basha, libër më të mirë, të këtij branshi nuk e di se do të kishit shkruar. Ky është një libër me plot histori, gjeografi, pedagogji dhe nostalgji. Pas leximit edhe unë u bëra pjesë e këtij itinerari, e ndjeva veten si student, dhe iu bashkëngjita takimeve që përfundonin me lot.
Të them: menaxhimi i juaj si edukatorë, po edhe si burrë e grua, më la përshtypje të madhe që treguat pjekuri në çdo aspekt, moral dhe etik.
Po e mbyll këtë mbresë: faleminderit shumë që e shkruat këtë libër. Ju, lumtë. Shëndet të mirë dhe libra tjerë.





## ERICH FRIED

### KOHA E GURËVE

*Pas kohës së bimëve*
*Pasoi koha e shtazëve*
*Pastaj koha e njerëzve*
*Tani është radha e gurëve*

*Po t'i dëgjosh gurët teksa flasin*
*Mëson*
*Se do të mbeten vetëm gurët*

*Po t'i dëgjosh njerëzit teksa flasin*
*Mëson*
*Se do të mbeten vetëm gurët*

### NJË NGA ATA QË MBIJETUAN
*Pas Ausschwitz-it*

*Mos më uroni fat*
*Për fatin*
*Që po jetoj*

*Ç'është jeta*
*Pas kaq shumë vdekjesh*
*Pse e bart atë*
*Mëkati i pafajshmërisë*
*E kundërmëkati*
*Rëndon*
*Aq shumë*
*Sa mëkati i vrasësve*
*Sa mëkati i tyre i gjakut*
*Sa ç'farosja e falur*

*Edhe sa herë*
*Do të duhet të vdes*
*Për atë*
*Që nuk vdiqa*
*Atje?*

### MARRJA E NËNSHTETËSISË

*Duar të bardha*
*Flokë të kuqe*
*Sy blu*

*Gurë të bardhë*
*Gjak i kuq*
*Buzë blu*

*Kocka të bardha*
*Rërë e kuqe*
*Qiell blu*

### PYETJE PËR IZRAELIN

*Në një botë të padrejtë*
*Të jesh i drejtë*
*Është vështirë*
*Në rast se përpiqesh*
*Rabbi Hillel ka pyetur*
*Para 2000 vjetësh*
*"Nëse unë nuk jam për vete*
*kush është për mua?"*
*Por të jesh i drejtë vetëm për vete*
*Vetëm pse të tjerët ishin të padrejtë?*
*(dhe fundi jo ata mbi të cilët sot po ushtrohet vetëdrejtësia ishin të padrejtit)*
*Rabbi Hillel ka pyetur*
*Para 2000 vjetësh*
*"Nëse unë jam vetëm për veten*
*çka jam unë?"*

*Sot këtë pyetje e bën shumëkush në Izrael:*
*Nëse nuk jemi për palestinezët*
*Çka jemi?*
*Ç'pasqyrim i vonuar*
*I armikut jemi atëherë?"*
*Mirëpo të tjerët thonë: "Ka kohë,*
*të mirat vijnë ngadalë"*

*Rabbi Hillel ka pyetur*
*Para 2000 vjetësh:*
*"Kur, nëse jo*
*sot?"*

***Përktheu nga gjermanishtja:***
***Ismet DACI***

E jashtëzakonshme

## Zhduket panda e rrallë e kuqe nga kopshti zoologjik



Një pandë e rrallë e kuqe është zhdukur nga një kopsht zoologjik në Belfast. Policia ka raportuar se panda u zhduk të dielën, ndërsa u kanë bërë thirrje njerëzve të kërkojnë për kafshën që është një specie e rrezikuar. Pandat e kuqe janë pak më të mëdha se macet shtëpiake. Kjo kafshë jeton në Himalaje në Butan, Kinën Jugore, Pakistan, Indi, Laos, Nepal dhe Birmania. Gjithashtu, njihet si 'panda më e vogël' ose 'fire-fox'. Ato e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në pemë.

FOTO E DITES



Një punëtor në Brazil shihet duke bërë përpjekje për ta shpëtuar lopën e cila ka mbetur në baltë. /AP/

E rrallë

## Gjen gjallë nënën 103-vjeçare pas 61 vjetësh kërkim



Një grua e moshuar ka gjetur nënën e vet 103-vjeçare pas 61 vjetësh kërkime. 81-vjeçarja, që u rrit në Kirwan House, një jetimore protestante në Dublin, nisi përpjekjet për ta gjetur nënën kur ishte 19-vjeçare. Macken telefonoi Radio RTE për t'i treguar moderatorit Joe Duffy se, më në fund, kishte gjetur nënën e saj dhe se ishte personi më i lumtur në botë.

## BARSOLETA E DITËS



**Njëra e thirri veterinerin në telefon:**
**- Macja ime piu 50 ml benzinë dhe filloi të vraponte, ndërsa tani është shtrirë në dysheme dhe nuk lëviz. Çfarë mendoni se mund t'i ketë ndodhur?**
**Veterineri:**
**- Duhet t'i ketë mbaruar benzina!**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney






Në ora 17:30

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers







Në ora 22:00

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Në familje po prisni një zhvillim të rëndësishëm. Jeni të mbërthyer nga një ankth i pashpjegueshëm.



**DEMI**
Këto ditë keni vendosur të ndryshoni pritshmëritë për një projekt të nisur. Mos prisni shumë që të mos zhgënjeheni më pas.



**BINJAKËT**
Partneri ju ka shprehur një shqetësim që për momentin mund të zgjidhet. Mos e lini pas dore.



**GAFORRJA**
Keni filluar të kërkoni në të kaluarën tuaj për fakte dhe persona që ju interesojnë për momentin.



**LUANI**
Keni një karrierë të suksesshme që po mundoheni ta shfrytëzoni edhe për përfitime financiare. Në këtë fushë duhet të prisni pak më shumë.



**VIRGJËRESHA**
Në shumë çaste mund të ndiheni keq dhe kjo do t'ju bëjë të thoni gjëra për të cilat do të pendoheni më pas.



**PESHORJA**
Edhe pse sot do të ketë shumë situata negative, ju nuk do të lejoni në asnjë çast t'ju prishin ditën dhe qetësinë tuaj.



**AKREPI**
Sot duhet të jeni më tolerant me të tjerët. Një fjalë e thënë më tepër mund të shkaktojë konflikt me një mik të mirë.



**SHIGJETARI**
Emocionalisht ndiheni të përmbushur dhe kjo gjë ju sjell në humor. Nuk do të vëreni disa probleme të vogla gjatë ditës.



**BRICJAPI**
Dikush ka nxjerrë anën më të keqe tuajën sot. Për këtë arsye do të jeni mjaft të ashpër edhe me persona që nuk e meritojnë.



**UJORI**
Nëse ka ardhur koha të zbuloni një sekret merrni më parë miratimin e personave që kanë lidhje me të.



**PESHQIT**
Çdo gjë që keni vendosur të bëni sot do të jetë pikërisht siç e kishit menduar. Edhe pse ngurroni, dikush do t'ju mbështesë.

# Shtatë muaj pas vdekjes së XXXTentacion, ka ardhur në jetë djali i tij



Reperi Jahseh Dwayne Onfroy, i njohur si XXXTentacion, kishte vdekur në moshë shumë të re. Shtatë muaj pas vdekjes së tij në jetë ka ardhur djali i tij nga e dashura e reperit Jenesis Sanchez. Nëna e XXXTentacion, Cleopatra Bernard dhe e dashura Jenesis Sanchez e kanë bërë me dije lajmin më 27 janar se Jenesis e kishte mirëpritur fëmijën Gekyume Onfro në këtë botë. Ai lindi tri ditë pas ditëlindjes së 21-të të babait të tij.

# Zac Efron pëlqehet më shumë si biond



Aktori hollivdian Zac Efron së fundi ka ndryshuar pamjen e tij. Ai i ka ngjyrosur flokët. Është bërë biond. Sipas "Hollywood Life", kjo dukje e re e Efron ngjalli shumë reagime pozitive, kështu fansat e aktorit del se e pëlqejnë shumë këtë dukje.



# Angelina Jolie blen kafshë për fëmijën e vet

Aktorja e famshme hollivudiane Angelina Jolie është fotografuar nga paparacët teksa dilte nga një dyqan i kafshëve së bashku me fëmijën e vet, Shiloh Jolie-Pitt. Sipas "Hollywood Life", ata të dy supozohet se kanë blerë një kafshë të re për familjen e tyre.

# Chriss Brown kthehet në Los Anxhelos



Reperi i famshëm botëror Chris Brown është kthyer në Los Anxhelos të shtunën me aeroplanin e vet privat nga Parisi. Chriss Brown para disa dite ishte akuzuar për përdhunim. Sipas "Daily Mail", reperi kishte blerë disa veshmbathje në Paris.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ARSENAL - CARDIFF | 4+ | WOLVERHAMPTON - WEST HAM | 1 | SWANSEA - BIRMINGHAM | 3+ |

# Tahiri: Nuk isha i respektuar te Vushtrria, prandaj u largova




Një nga heronjtë e titullit të fituar me skuadrën e Vushtrrisë në rangun elitar të futbollit në Kosovë, Petrit Tahiri, është larguar nga kjo skuadër duke u arsyetuar se nuk është respektuar sa duhet nga drejtuesit e klubit. "Trajtimi joserioz ndaj meje, pas marrjes së vendimit nga kryesia pa arsye, që ta shkel kontratën për të ma zvogëluar pagën, ma ka nxitur ta lë këtë ekip. Nuk është se varem nga paga e futbollit, sepse për Vushtrrinë shumë raste kam luajtur edhe pa asnjë cent si, për shembull, kemi luajtur dhjetë muaj pa pagesë dhe jemi shpallur kampionë të Kosovës. Thjesht, është në pyetje karakteri dhe krenaria ime", ka thënë Tahiri

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

**Prishtinë, 28 janar** - Portieri Petrit Tahiri të dielën e bëri publik lajmin për largim nga skuadra e Vushtrrisë, kurse të hënën për "Epokën e re" ka zbuluar arsyen e këtij largimi nga skuadra e tij e zemrës. Ai ka thënë se drejtuesit e klubit nuk i kanë kryer obligimet që kishin ndaj tij, prandaj largimi ishte i pashmangshëm. "Arsyeja e largimit është mospërmbushja e obligimeve ndaj meje që i kam pasur të cekura në kontratë. Trajtimi joserioz ndaj meje, pas marrjes së vendimit nga kryesia pa arsye, që ta shkel kontratën për të ma zvogëluar pagën, ma ka nxitur ta lë këtë ekip. Nuk është se varem nga paga e futbollit, sepse për Vushtrrinë shumë raste kam luajtur edhe pa asnjë cent si, për shembull, kemi luajtur dhjetë muaj pa pagesë dhe jemi shpallur kampionë të Kosovës. Thjesht, është në pyetje karakteri dhe krenaria ime. Ne lojtarët e vushtrrias kemi dhënë gjithçka për këtë klub dhe në disa raste jemi përbuzur për fat të keq dhe nuk kemi pasur trajtimin e duhur. Këto janë arsyet që më kanë detyruar të largohem nga klubi", ka thënë Petrit Tahiri.

Pavarësisht se është larguar nga ky klub, Tahiri dëshiron shumë dhe beson se skuadra e Vushtrrisë mund të rikthehet në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Shanset janë shumë të mira për Vushtrrinë të inkuadrohet në Superligë pasi në radhët e veta ka lojtarë të dëshmuar dhe shumë kualitativë. Po ashtu, një plus i madh i saj janë tifozët e flakët 'Forca', edhe i gjithë qyteti i Vushtrrisë që i qëndron mbas", ka deklaruar ai.

Portieri Petrit Tahiri ka luajtur edhe për Hajvalinë, Trepçën, Wirgesin në Gjermani. Po ashtu, ka qenë pjesë e përfaqësueses së Kosovës në U19 dhe U21.

### Tahiri shkon te Vllaznia e Pozharanit

Portieri Petrit Tahiri, pas largimit nga skuadra e Vushtrrisë, nuk ka humbur kohë dhe ka arritur marrëveshje me skuadrën tjetër nga Liga e Parë, Vllazninë e Pozharanit. Portieri në fjalë ka bërë me dije se me skuadrën e re synon ta sigurojë mbijetesën në rangun e garave që aktualisht bën pjesë. "Oferta kam pasur nga disa klube, por kam vendosur që në gjashtë muajit e ardhshëm të jem pjesë e Vllaznisë së Pozharanit, pasi oferta e tyre ishte serioze dhe përmbushi kërkesat e mia. Vllaznia nuk qëndron mirë në tabelë dhe synimet janë që të ngjitemi sa më lart, pra mos ta rrezikojmë rënien në një rang më të ulët", ka deklaruar ai.

Portieri Petrit Tahiri sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e parë me skuadrën e Vushtrrisë, kurse në sezon pranveror do të luftojë me Vllazninë që të largohet nga pozita e fundit në renditjen tabelore, pasi skuadra nga Pozharani ka vetëm tetë pikë të grumbulluara.

## SHKURT

### Ambasadori Cufaj shtron darkë për drejtuesit e FFK-së

Ambasadori i Kosovës në Gjermani, Beq Cufaj, ka shtruar darkë për drejtuesit e Futbollit të Kosovës. Në delegacionin e FFK-së bënin pjesë Agim Ademi (kryetar), Eroll Salihu (sekretar i përgjithshëm), Vjollca Krasniqi, Mirsad Çollaku dhe Bekim Rexhepi, e ku të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e FFShGj-së. Me këtë rast ambasadori Cufaj e përgëzoi presidentin Ademi për punën dhe rezultatet e arritura dhe u pajtuan për punët e përbashkëta për futbollin dhe organizimet e shqiptarëve në Gjermani dhe raportet me DFB-në dhe klubet e Gjermanisë.

### Sot dy miqësore në Durrës

Skuadra e Drenicës sot (e martë) do ta zhvillojë ndeshjen e fundit miqësore sa i përket fazës përgatitore në Durrës. Kundërshtare e kuqezinjve nga Skenderaj do të jetë skuadra e Llapit, kurse ndeshja zhvillohet nga ora 11:30 në Kompleksin Sportiv "Olympic" në Durrës. Pikërisht në këtë fushë nga ora 14:00 zhvillohet edhe miqësorja e dytë në mes të Gjilanit dhe Trepçës '89.

### Shala, afër marrëveshjes me Stabaekun

Mesfushori i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Herolind Shala, i është bashkuar skuadrës së Stabaekut në Tailandë, vend në të cilin klubi norvegjez po zhvillon fazën përgatitore para nisjes së sezonit në muajin mars. Megjithatë, ende nuk ka asgjë lidhur me një transferim zyrtar. Drejtori sportiv i Stabaekut, Andre Olsen, ka konfirmuar për "eurosport.no" se Shala i është bashkuar ekipit në fazën përgatitore, por për të arritur në një marrëveshje do të duhet pak kohë. Futbollisti 26-vjeçar spikati me skuadrën e Startit, edhe pse kjo e fundit nuk i shpëtoi rënies nga "Elliteserien". Në rast se për Shalën nuk vjen ndonjë ofertë e volitshme nga kampionat i huaj, e ardhmja e 26-vjeçarit në Norvegji do të jetë me Stabaekun.

### Presidenti i Luganos: Me Sadikun jemi për Evropë
